



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1542/4 Prot

Tiranë, më 27.12.2019

V E N D I M

Nr. 222, datë 27.12.2019

Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 1542 prot., datë 29.10.2019, të shtetasit *** , në lidhje me disa pretendime për parregullsi të kryera/lejuara në procedurën e transferimit pas përfundimit të periudhës së pezullimit, si dhe gjatë zhvillimit të një ecurie disiplinore në ngarkim të tij.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e pretendimeve të ngritura nga nëpunësi ***** ,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të rregjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nr. 1542 prot., datë 29.10.2019, nëpunësi ***** ka ngritur pretendimin se procedura e transferimit të tij pas përfundimit të periudhës së pezullimit, në pozicionin *“Përgjegjës i Shërbimeve”*, në Njësinë Administrative Stavraj, në Bashkinë Prrerjas, nuk është zhvilluar në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe vendimin nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*, i ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit të materialeve të administruara në kuadër të hetimit administrativ rezulton si më poshtë:

Me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar (në datën 26.02.2014), nëpunësit ***** i ka lindur e drejta e përfitimit të statusit të nëpunësit civil në pozicionin *“Përgjegjës i Zyrës së Tatim-Taksave”*, në ish Komunën Rrajcë, në

Bashkinë Prrenjas, për arsye se në atë kohë, kishte më shumë se një vit që kryente këtë detyrë, e megjithatë, deklarimi i statusit për këtë punonjës është bërë me aktin nr. 369 prot., datë 12.02.2018, të njësisë përgjegjëse të Bashkisë Prrenjas, pas ndërhyrjes së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në kuadër të ushtrimit të mbikëqyrjes, me vendimin paralajmërues nr. 13, datë 16.03.2018.

Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes së përgjithshme në Bashkinë Prrenjas është konstatuar gjithashtu, se punonjësi ***** me aktin nr. 464, datë 21.09.2017, të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas, *“Për lëvizje në detyrë”*, është emëruar në pozicionin *“Nënkryetar”*, i Bashkisë, pozicion i cili në kuptim të nenit 2, germa “gj”, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, klasifikohet si pozicion i funksionarit të kabinetit.

Për këtë arsye, në zbatim të nenit 54, pika 1, germa 4, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, Komisioneri, në pikën 3, të vendimit paralajmërues nr. 13, datë 16.03.2018, ka kërkuar prej njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të këtij institucioni, nxjerrjen e aktit për pezullimin nga shërbimi civil për nëpunësin në fjalë. Në zbatim të detyrës së mësipërme, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Prrenjas, me aktin administrativ nr. 25, datë 20.03.2018, ka vendosur pezullimin nga shërbimi civil për nëpunësin *****, duke përfshirë periudhën e kryerjes së detyrës *“Nënkryetar i Bashkisë Prrenjas”*, e cila ka filluar në datën 21.03.2018.

Në të njëjtën kohë Kryetari i Bashkisë Prrenjas, me urdhrin e brendshëm nr. 104, datë 20.03.2018, ka vendosur shkëputjen e marrëdhënies financiare të punonjësit në fjalë, nga pozicioni *“Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave”*, në Njësinë Administrative Rrajcë, kategoria e pagës III-b, duke u paguar vetëm për pozicionin e nënkryetarit të bashkisë.

Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se, Kryetari i Bashkisë, me urdhrin nr. 265, datë 17.07.2019, *“Për lëvizje në detyrë”*, ka vendosur lëvizjen në detyrë të nëpunësit *****, nga pozicioni i punës *“Nënkryetar i Bashkisë Prrenjas”*, në pozicionin e punës *“Drejtor i Drejtorisë së Tatim Taksave”*, në këtë institucion.

Duke vlerësuar ligjshmërinë e veprimit të mësipërm, konstatohet se akti i emërimit në pozicionin *“Drejtor i Drejtorisë së Tatim Taksave”* për nëpunësin *****, ka dalë në kundërshtim me përmbajtjen e neneve 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, ku përcaktohet në mënyrë të qartë se, pozicionet e shërbimit civil plotësohen vetëm nëpërmjet një procedure të rregullt konkurrimi, konkretisht nëpërmjet lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit të ulët ose të mesëm drejtues.

Në rastin konkret, emërimi është bërë nëpërmjet një akti të përkohshëm, të nxjerrë nga titullari i institucionit, i cili në kuptim të dispozitave të nenit 108, germa “a”, pika i) dhe ii)

dhe germa “ç”, të të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së SHqipërisë”, përbën një akt absolutisht të pavlefshëm.

Për me tepër, në referencë të strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas, miratuar me vendimin nr. 79, datë 10.04.2019, të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Prrenjas dhe institucioneve në varësi, bazuar në numrin total dhe nivelin e pagave të miratuara nga Këshilli Bashkiak”, strukturë e cila ka qenë në fuqi në momentin e kryerjes së veprimit të mësipërm administrativ, vërehet se pozicioni “Drejtor i Drejtorisë së Tatim Taksave”, nuk është parashikuar në strukturën e institucionit.

Në lidhje me sa më sipër, Kryetari aktual i Bashkisë Prrenjas, pas marrjes së detyrës, nëpërmjet urdhrit nr. 295, datë 05.09.2019, ka kërkuar ngritjen e një grupi të posaçëm pune (komision), me qëllim verifikimin e emërimeve, shkarkimeve dhe transferimeve të punonjësve të Bashkisë Prrenjas të kryera në kundërshtim me ligjin. Në përmbajtjen e relacionit të datës 07.08.2019, komisioni ndër të tjera ka evidentuar si emërim të kryer në kundërshtim me përcaktimet e ligjit për nëpunësin civil, edhe rastin e nëpunësit *****.

Me qëllim rregullimin e ligjshmërisë, vërehet se, Kryetari i Bashkisë Prrenjas, në referencë të gjetjeve të pasqyruara nga grupi i posaçëm, me aktin nr. 161, datë 07.08.2019, ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 265, datë 17.07.2019, të Kryetarit të Bashkisë, “Për emërimin në detyrë të punonjësit ***** në pozicionin Drejtor i Tatim Taksave”, si një akt të nxjerrë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, akt i cili i është njoftuar këtij nëpunësi me shkresën nr. 2350 prot., datë 13.08.2019.

Ndërkohë, referuar dokumentacionit të administruar, konstatohet se gjatë kësaj periudhe, me vendimin nr. 165, datë 15.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 79, datë 10.04.2019, të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Prrenjas dhe institucioneve në varësi, bazuar në numrin total dhe nivelin e pagave të miratuara nga Këshilli Bashkiak”, është miratuar struktura e re organizative e këtij institucioni, nga përmbajtja e të cilës rezulton se pozicioni i punës “Nënkryetar”, i cili ka shërbyer si shkak ligjor për pezullimin e nëpunësit ***** nga shërbimi civil, është suprimuar.

Me marrjen dijeni për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Tatim Taksave”, nëpunësi ***** , ka shprehur kundërshtimin e tij nëpërmjet shkresës nr. 2350/1 prot., datë 16.8.2019, duke argumentuar se veprimi i mësipërm administrativ, jo vetëm që është i pabazuar në ligj, por është kryer në kohë të papërshtatshme, për shkak se në kohën e nxjerrjes së tij, ai ka qenë duke kryer lejen vjetore. Njëkohësisht, në përmbajtje të kësaj shkrese, ankuesi ka kërkuar informacion në lidhje me pasojat juridike të konstatimit të pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit për

pozicionin “Drejtor”, konkretisht në lidhje me pozicionin e punës ku ai do duhet të ushtrojë detyrën në të ardhmen, në kushtet kur rezulton të jetë nëpunës civil i pezulluar.

Nisur nga rrethanat e mësipërme, si dhe në zbatim të Kreut II, pika 16 dhe 16/1, të vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, i ndryshuar, rezulton se njësia përgjegjëse, në kushtet e konstatimit të rënies së shkakut të pezullimit, ka kërkuar prej nëpunësit ***** paraqitjen e një kërkesë nëpërmjet të cilës të shprehte vullnetin e tij për vijimësinë ose jo të marrëdhënies në shërbimin civil, fakt i cili materializohet në shkresën nr. 2350/1 prot., datë 28.08.2019 dhe në shkresën nr. 2553 prot., datë 02.09.2019, të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas.

Në kushtet kur, nëpunësi ka refuzuar paraqitjen e kësaj kërkesë (*fakt që materializohet në shkresën nr. 2553/1 prot., datë 03.09.2019*), njësia përgjegjëse me vendimin nr. 173, datë 04.09.2019, ka vendosur heqjen e pezullimit nga shërbimi civil dhe ka filluar shqyrtimin e mundësisë së transferimit të tij në një pozicion të barasvlefshëm të shërbimit civil, të së njëjtës kategori (*pasqyruar kjo në procesverbalin nr. 2581/1 prot., datë 06.09.2019*), sepse rikthimi në pozicionin e mëparshëm të punës “Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave”, në ish Komunën Rrajcë, ishte i pamundur pasi me strukturën në fuqi ky pozicion ishte suprimuar.

Në përfundim të këtij procesi, me aktin nr. 174, datë 06.09.2019, të njësisë përgjegjëse, nëpunësi ***** , është transferuar në pozicionin “Përgjegjës i Shërbimeve”, në Njësinë Administrative Stavraj – kategoria e pagës III-b. Nëpunësi nuk ka qenë dakord me këtë akt, duke pretenduar për paligjshmëri dhe pavlefshmëri të tij, pretendime të cilat i ka parashtruar nëpërmjet letrës të protokolluar me nr. 2600/1 prot., datë 12.09.2019 (*drejtuar Bashkisë Prrenjas*), si dhe në shkresën nr. 1542 prot., datë 29.10.2019, nëpërmjet të cilës ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Pasi ka parashtruar pretendimet e tij për paligjshmëri të aktit të transferimit si më sipër, nëpunësi ***** , pa paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk ka pranuar të paraqitet në pozicionin e punës e për këtë shkak, Kryetari i Bashkisë Prrenjas, ka kërkuar fillimin e ecurisë disiplinore ndaj këtij nëpunësi, për shkak të mungesës së tij të pajustificuar dhe të vijueshme, për më shumë se 7 ditë pune.

Në zbatim të nenit 57, pika 2, germa ç), të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, veprimi i mësipërm është klasifikuar si shkelje shumë e rëndë disiplinore dhe për këtë arsye, Kryetari i Bashkisë Prrenjas, me urdhrin nr. 380, datë 23.09.2019, ka vendosur ngritjen e Komisionit Disiplinor, i cili me aktin nr. 2908 prot., datë 24.09.2019, ka filluar ecurinë disiplinore. Akti i është komunikuar nëpunësit, duke i njoftuar dhe datën e zhvillimit të seancës dëgjimore, 01.10.2019.

Pas disa shtyrjeve të seancave dëgjimore për shkak të mosparaqitjes së palëve, përfundimisht, seanca për shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara se janë kryer prej ankuesit, është zhvilluar në datën 22.10.2019 dhe në përfundim të saj Komisioni Disiplinor, me vendimin nr. 234, datë 22.10.2019, ka vendosur ndërprerjen dhe pushimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit *****. Në pjesën arsyetuese të vendimit, Komisioni Disiplinor ka argumentuar se, veprimet e nëpunësit në fjalë, konkretisht mos paraqitja në pozicionin e punës pas njohjes me aktin e transferimit, nuk përbën thyerje të disiplinës në punë por është shprehje e refuzimit të tij ndaj aktit të transferimit, refuzim i cili është shprehur edhe në letrën e tij protokolluar me nr.2600/1 prot., datë 11.09.2019, e cila u përmend dhe më lart.

Në zbatim të pikës 20, të Kreut II, të vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se, refuzimi i transferimit, për arsye të tjera përveç pikës 19, të po këtij vendimi, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil, Komisioni Disiplinor ka argumentuar se njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Bashkisë Prrenjas, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, që në këtë moment duhet të kishte vijuar me lirim nga shërbimi civil të nëpunësit në fjalë.

Në këto kushte, pas marrjes dijeni të kësaj vendimmarrje të Komisionit të Disiplinës, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, me aktin nr. 237, datë 28.10.2019, ka vendosur lirim nga shërbimi civil për nëpunësin ***** dhe më tej, me urdhrin nr. 443, datë 28.10.2019, të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas, është vendosur ndërprerja e marrëdhënies së tij të punës dhe asaj financiare.

Duke analizuar gjithë sa është parashtruar më sipër, në vlerësim të rrethanave të çështjes dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, Komisioneri vlerëson se, procedura e transferimit të nëpunësit civil ***** , pas përfundimit të periudhës së pezullimit nga shërbimi civil, është kryer në përputhje me përcaktimet e nenit 56, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreut II, të vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, i ndryshuar.

Neni 56, pika 1, e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, përcakton se, në përfundim të afatit apo rënies së shkakut të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, nëpunësi civil rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ose në rast se pozicioni i mëparshëm është plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori.

Në rastin konkret, nëpunësi ***** ishte pezulluar nga shërbimi civil në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave”, në ish Komunën Rrajcë me kategori page III-b. Në momentin e rënies së shkakut të pezullimit, pozicioni i mëparshëm i punës “Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave”, në ish Komunën Rrajcë, ishte suprimuar si rrjedhojë e zbatimit të

reformës territoriale në njësitë e qeverisjes vendore dhe ristrukturimit të Bashkisë Prrenjas e për këtë arsye ishte objektivisht i pamundur rikthimi në vendin e mëparshëm të punës.

Në këto kushte njësia përgjegjëse ka vijuar me shqyrtimin e mundësisë së transferimit të këtij nëpunësi në një pozicion tjetër të të njëjtës kategori, në shërbimin civil. Në zbatim të përcaktimeve të mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, transferimi i nëpunësit në këtë rast, në pozicionin “Përgjegjës i Shërbimeve”, në Njësinë Administrative Stavraj, me kategori page III-b, është kryer duke respektuar kërkesën ligjore të respektimit të kategorisë së pozicionit të mëparshëm dhe kushtin e plotësimit të kërkesave të vendit të punës, duke hedhur poshtë pretendimet e këtij nëpunësi për paligjshmëri dhe pavlefshmëri të kësaj procedure administrative.

Për më tepër, në analizë të strukturës aktuale të Bashkisë Prrenjas, vërehet se pozicioni i punës “Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave”, pjesë e administratës së bashkisë, i përket një kategorie më të lartë pasi, tashmë organizimi është si sektor dhe jo si zyrë, ç’ka pasqyrohet edhe në një nivel më të lartë page, III-a/1. Ky fakt përcakton se, mënyra e vetme e emërimit të këtij nëpunësi në këtë pozicion, mund të bëhej nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Njëkohësisht, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vlerëson si të pabazuar edhe pretendimin tjetër të ankuesit *****, se paligjshmëria e aktit nr. 174, datë 06.09.2019, të njësisë përgjegjëse, për transferimin e tij në pozicionin “Përgjegjës i Shërbimeve” në Njësinë Administrative Stavraj, në përfundim të periudhës së pezullimit, është rrjedhojë e mos dhënies së pëlqimit nga ana tij, në lidhje me këtë veprim administrativ.

Vendimi nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, i ndryshuar, në Kreun II të tij, përcakton në mënyrë të detajuar procedurën, që duhet të ndiqet nga njësia përgjegjëse, për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës ose transferimin e nëpunësit civil, në përfundim të periudhës së pezullimit.

Konkretisht, në pikën 16 dhe 16/1, të aktit të mësipërm nënligjor, përcaktohet se nëpunësi civil me rënien e shkakut të pezullimit, duhet të njoftojë njësinë përgjegjëse në lidhje me këtë fakt, jo më vonë se 15 ditë kalendarike përpara afatit të përfundimit të pezullimit. Nëse nëpunësi nuk realizon një njoftim të tillë, atëherë njësia përgjegjëse, merr masa për të kërkuar nga nëpunësi shprehjen e tij me shkrim në lidhje me vijimësinë e marrëdhënies në shërbimin civil.

Në rastin konkret, në praktikën shkresore të procesit të përfundimit të periudhës së pezullimit, nuk rezulton të ketë ndonjë akt apo praktikë administrative, që të provojnë se njësia përgjegjëse e Bashkisë Prrenjas, ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e mësipërme ligjore. Për më tepër, vlen të theksohet se, nëpërmjet shkresës nr. 2350/1 prot., datë 28.08.2019 dhe shkresës nr. 2553 prot., datë 02.09.2019, të Kryetarit të Bashkisë

Prrenjas, në mënyrë të vazhdueshme njësia përgjegjëse ka kërkuar prej nëpunësit në fjalë, paraqitjen në ambjentet e institucionit, me qëllim diskutimin e vijimësisë së tij në marrëdhënien e shërbimit civil, kërkesë e cila rezulton të jetë refuzuar prej tij me pretendimin se, njësia përgjegjëse ka detyrimin ligjor të kryerjes së këtyre veprimeve administrative, pa paraqitjen e kësaj kërkesë nga nëpunësi civil.

Nga ana tjetër, referuar përcaktimeve të dispozitave të aktit nënligjor të sipërpërmendur, procedura e kthimit në vendin e mëparshëm të punës apo transferimit të nëpunësit në përfundim të periudhës së pezullimit, nuk lidhet me dhënien e miratimit prej këtij të fundit. Në bazë të pikës 19, të vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil*”, i ndryshuar, nëpunësi civil, ka të drejtën të refuzojë aktin e transferimit vetëm për shkaqet e mëposhtme:

- a) *Kur gjendja e tij shëndetësore, provuar më vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;*
- b) *Nëse vendi kur transferohet gjendet më shumë se 45 km, nga vendbanimi i nëpunësit civil.*

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Prrenjas ka vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pasi në nenin 56, pika 1/ 2 të këtij ligji, dhënia e pëlqimit nga ana e nëpunësit kërkohet *vetëm në rastet kur njësia përgjegjëse, në pamundësi të sistemit të tyre në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, vendos emërimin e tyre në pozicione të lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme.*

Në vijim të shqyrtimit të rastit konkret, Komisioneri, në vlerësim të rrethanave dhe dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ, çmon se fillimi i ecurisë disiplinore në ngarkim të nëpunësit ***** , ka ardhur si rrjedhojë e intepretim të gabuar të dispozitave të legjislacionit për shërbimin civil nga ana e njësisë përgjegjëse.

Konkretisht, nga sa është parashtruar më sipër, rezulton se, shkak i fillimit të ecurisë disiplinore në rastin e nëpunësit në fjalë, ka qenë mosparaqitja e tij në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Shërbimeve*”, në në Njësinë Administrative Stavraj. Bashkia Prrenjas, veprim i cili është trajtuar si mungesë e pajustificuar dhe e vijueshme për mbi 7 ditë pune, të cilat në kuptim të nenit 57, pika 2, germa ç), të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, përbëjnë shkelje shumë të rëndë disiplinore dhe për këtë arsye, Kryetari i Bashkisë Prrenjas ka vijuar me ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e tyre.

Në rastin konkret, mosparaqitja në punë prej këtij nëpunësi, nuk përbën thyerje të disiplinës në punë por përbën një shprehje të hapur të refuzimit të tij në lidhje me transferimin

në një pozicion tjetër, të të njejtës kategori, në pamundësi për tu kthyer në pozicionin e mëparshëm të punës.

Në Kreun II, pika 20, të vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përveç pikës 19, të këtij vendimi, përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil”.

Pra, në këtë rast, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Prrenjas duhet të kishte vepruar direkt për lirimin nga shërbimi civil të nëpunësit *****, që në momentin e marrjes dijeni të refuzimit nga ana e tij, dhe jo të kërkonte fillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të tij.

Megjithatë Komisioneri vlerëson se, kjo situatë paligjshmërie është rregulluar nga ana e Komisionit Disiplinor, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, me vendimin nr. 234, datë 22.10.2019, ka vendosur ndërprerjen dhe pushimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit *****, duke argumentuar se, veprimet e kryera nga ky nëpunës nuk përbëjnë shkelje të disiplinës në punë, por shprehin refuzimin e tij në lidhje me këtë transferim.

Në vijim të këtyre veprimeve administrative, rezulton se njësia përgjegjëse e Bashkisë Prrenjas, në zbatim të dispozitave ligjore të parashtruara më sipër, si dhe në referencë të vendimit të Komisionit Disiplinor, me të drejtë, me aktin nr. 237, datë 28.10.2019, ka vendosur lirimin nga shërbimi civil për nëpunësin *****.

Nga sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në përfundim se pretendimi i parashtruar nga nëpunësi *****, nëpërmjet kërkesës nr. 1542 prot., datë 29.10.2019, për paligjshmëri në zhvillimin e procedurës së transferimit, në përfundim të periudhës së pezullimit nga shërbimi civil, si dhe gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të tij, është i padrejtë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 1542 prot., datë 29.10.2019, të nëpunësit ***** , në lidhje me disa pretendime për parregullsi të kryera apo lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së procedurës së transferimit në një pozicion tjetër të të njëjtës kategori në shërbimin civil, në pamundësi për ta kthyer në pozicionin e mëparshëm të punës pas përfundimit të periudhës së pezullimit, si dhe gjatë zhvillimit të një ecurie disiplinore në ngarkim të tij.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Prrenjas, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Prrenjas dhe kërkuesi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha